TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE | BALFIN

# BACHELOR
## NË ADMINISTRIMI BIZNESI



**STUDIOJE BIZNESIN SOT,**
**UDHËHIQE ATË**
**NESËR!**

Kohëzgjatja: **36 muaj**
Gjuha: **Shqip**
Vendodhja: **Tiranë**

Skano për më shumë info

# MESAZHI I DREJTUESIT AKADEMIK TË PROGRAMIT



"Të nderuar studentë të rinj,
Si Shef i Departamentit të Biznesit dhe Financës, kam kënaqësinë t'ju mirëpres me zemër në Programin e Bachelorit në Administrim Biznesi. Ky program, me një strukturë solide moderne, është krijuar për t'ju ofruar bazën e nevojshme të njohurive dhe aftësitë praktike që do t'ju nevojiten për të filluar me sukses në botën dinamike të biznesit.
Gjatë studimeve tuaja, do të ndërtoni njohuri të thella në disiplina kryesore të administrimit, financave, marketing-ut, menaxhimit dhe sipërmarrjes. Fakulteti ynë kushtëzohet për një mësimdhënie cilësore dhe interaktive, duke kombinuar teorinë me studime rasti, projekte dhe simulime praktike, në mënyrë që të jeni të përgatitur për sfidat reale të tregut.
Veç lëndëve thelbësore, ju inkurajojmë të përfshiheni në aktivitete jashtë kurrikulës, nisma studentore, mundësi praktike dhe takime me profesionistë të biznesit.
Këto mundësi do t'iu ndihmojnë të zhvilloni jo vetëm aftësi profesionale, por dhe rrjetin tuaj të kontakteve dhe mendimin kritik. Jemi shumë të gëzuar për rrugëtimin që do të nisim së bashku dhe me padurim presim kontributin dhe energjinë tuaj në komunitetin tonë akademik. Për çdo pyetje, udhëzim ose nevojë mbështetëse gjatë programit, stafi ynë dhe unë jemi plotësisht në dispozicionin tuaj. Suksesi juaj është prioriteti ynë.

Ju uroj një fillim të mbarë dhe plot suksese!

Me respekt,
**Dr. Gerti Dajçi**
Shef i Departamentit të Biznesit dhe Financave

# PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT

Qëllimi i programit të Studimit Bachelor në Administrim – Biznesi është të përgatisë profesionistë të shkolluar dhe të profilizuar në fushat kryesore të biznesit – Menaxhimi, Marketing dhe Financë-Kontabilitet. Programi Bachelor në Administrim Biznesi (180 ECTS) në TBU ofron një përvojë arsimore të fuqishme, gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt tregut. Ai siguron thellësi njohurish, përvojë kërkimore, perspektiva të zgjeruara karriere dhe zhvillim të qëndrueshëm profesional. Ky program përbën një zgjedhje të shkëlqyer për studentët që synojnë të ndërtojnë një karrierë të suksesshme në biznes, të vazhdojnë studimet në cikle më të larta dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive në zhvillimin ekonomik dhe shoqërore. Programi synon t'i pajisë studentët me një kuptim gjithëpërfshirës të mekanizmave të biznesit dhe t'i aftësojë ata për të:

- Analizuar mjedisin ekonomik, ligjor dhe konkurrues.
- Zgjidhur probleme komplekse dhe të paparashikueshme në kontekste reale biznesi.
- Vendosur dhe implementuar strategji efektive në specializimin e zgjedhur.
- Objektivat konkrese të programit përfshijnë:
- Punësim i Suksesshëm: Synimi ynë kryesor është që studentët tanë të jenë të punësuar në pozicione që korrespondojnë me profilin e tyre brenda 3 vitesh nga diplomimi.
- Zhvillim i Njohurive Themelore dhe Specializuese: Ofrimi i një baze të fortë teorike, të ndërtuar mbi praktikat më të mira ndërkombëtare dhe të përshtatura me realitetin e ekonomisë shqiptare, duke hapur rrugë për studime të mëtejshme master.
- Aftësim për Zhvillim Karriere: Përgatitja e studentëve jo vetëm për një punë, por për të zënë pozicione me përgjegjësi, ku kërkohen aftësi udhëheqëse, vendimmarrje strategjike dhe menaxhim inovativ.
- Përvojë e Drejtpërdrejtë në Industri: Sigurimi i mundësisë për praktika profesionale në kompani partnere, duke kombinuar mësimin në klasë me eksperiencën e botës reale.
- Konkurrueshmëri Globale: Krijimi i një profile profesionale të diplomuarit që është konkurrues jo vetëm në Shqipëri, por edhe në tregun ndërkombëtar të punës.

## DALLIMI KRYESOR NË PROGRAMIN BACHELOR NË ADMINISTRIM BIZNESI 180 ËSHTË SE OFRON:

### 1 | THELLËSIA E NJOHURIVE

**Kurrikulë Gjithëpërfshirëse**
Programi 180 ECTS lejon një eksplorim të gjerë dhe të thelluar të koncepteve, teorive dhe praktikave të biznesit, duke mbuluar në detaje fusha si:

- Menaxhimi dhe lidershipi;
- Financat dhe kontabiliteti;
- Marketingu dhe shitjet;
- Operacionet dhe menaxhimi i cilësisë;
- Sipërmarrja dhe inovacioni.

**Specializimet dhe Lëndët Zgjedhore**
Programi ofron një gamë më të gjerë lëndësh zgjedhore dhe profile specializimi, duke u mundësuar studentëve të përshtatin formimin e tyre sipas interesave dhe objektivave të karrierës, si p.sh. marketing dixhital, biznes ndërkombëtar, sipërmarrje apo menaxhim projektesh.

### 2 | KOMPONENTI KËRKIMOR

**Projekt/Tezë Bachelor**
- Programi përfshin realizimin e një projekti ose teze kërkimore, e cila nxit studentët të analizojnë në mënyrë të thelluar problematika reale të biznesit dhe të aplikojnë metoda shkencore kërkimi.

**Metodologjia e Kërkimit**
- Studentët pajisen me njohuri dhe aftësi kërkimore, të vlefshme për karrierë akademike, konsulencë biznesi dhe vendimmarrje të bazuar në të dhëna.

## 3 | PËRVOJË E ZGJERUAR MËSIMORE

**Kohëzgjatja dhe Ritmi i Studimit**

- Struktura trevjeçare e programit mundëson një ritëm më të ekuilibruar studimi, duke përmirësuar përvetësimin e njohurive dhe aftësive profesionale.

**Praktika dhe Përvoja Praktike**

- Programi ofron më shumë hapësirë për praktikë profesionale, projekte reale dhe bashkëpunim me biznese, duke krijuar përvojë konkrete dhe mundësi rrjetëzimi.

## 4 | MUNDËSI TË RRITURA PËR KARRIERË

**Avantazh Konkurrues në Tregun e Punës**

- Thellësia e studimit dhe kualifikimi 180 ECTS i veçon të diplomuarit në tregun e punës, veçanërisht për role që kërkojnë aftësi analitike, strategjike dhe menaxheriale.

**Përgatitja për Lidership**

- Programi fokusohet në zhvillimin e aftësive të forta dhe të buta, duke përgatitur studentët për pozicione drejtuese dhe role me përgjegjësi të lartë.

## 5 | RRJETËZIMI DHE BASHKËPUNIMI

**Rrjet i Fortë Alumni**

- Kohëzgjatja e programit kontribuon në ndërtimin e një komuniteti studentësh dhe alumni të angazhuar, duke krijuar marrëdhënie profesionale afatgjata.

**Projekte Bashkëpunuese**

- Programi nxit punën në grup dhe projektet ndërdisiplinore, duke zhvilluar aftësi komunikimi, bashkëpunimi dhe zgjidhjeje problemesh.

## 6 | ZHVILLIMI PROFESIONAL DHE SOFT SKILLS

**Programi i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit të:**

- aftësive ndërpersonale;
- inteligjencës emocionale;
- aftësive drejtuese;
- etikës profesionale dhe përgjegjësisë sociale.

# PËRFITIMET

Pjesëmarrja në këtë program ofron një sërë përfitimesh të rëndësishme që do t'ju përgatisin për një karrierë të suksesshme dhe dinamike në botën e biznesit:

**TI**

### 1. PROFILIZIM I QARTË

Zgjedhja e një prej tre profileve (Menaxhim, Marketing, Financë-Kontabilitet) që nga fillimi, duke ju lejuar të thelloheni në fushën tuaj të interesit.

### 2. EKSPERIENCË E VËRTETË PRAKTIKE

Praktika Profesionale e strukturuar gjatë çdo viti studimi në një rrjet të gjerë prej mbi 150 kompanish partnere, duke përfshirë kompani të tilla si Tirana Bank, BALFIN IT, Jumbo, Raiffeisen Bank, etj.

### 3. RRJETËZIM & MUNDËSI PUNËSIMI

Akses i drejtpërdrejtë në tregun e punës përmes partnerëve të universitetit, duke rritur shanset për punësim menjëherë pas diplomimit.

### 4. ZHVILLIM I AFTËSIVE TË BUTA

Theks i veçantë në komunikim, punë në grup, kreativitet dhe inteligjencë emocionale përmes lëndëve dhe projekteve specifike.

### 5. MJEDIS NDËRKOMBËTAR

Kurrikula e harmonizuar me standardet evropiane dhe fokusi në anglishten e biznesit përgatisin për sfidat globale.

# PERSPEKTIVAT E PUNËSIMIT TË HAPURA NGA BACHELOR NË ADMINISTRIM BIZNESI

**Me programin Bachelor në Administrim Biznesi ju mund të punësoheni në:**

- Administratë Publike, qendrore dhe vendore, si specialistë dhe drejtues financiarë, të burimeve njerëzore, marrëdhënieve me publikun, prokurimeve, menaxhimit të projekteve, etj.
- Sektorin privat, si: specialistë dhe drejtues të financës, kontabilitetit, auditit, burimeve njerëzore, marketingut, shitjeve, marrëdhënieve me klientin, menaxhimit të cilësisë, etj.
- Organizata jofitimprurëse, si: specialistë, drejtues dhe vlerësues projektesh, etj.

# PROFESIONE PËR TË CILAT JU MUND TË AFTËSOHENI:

- Sales Manager
- Operations Manager
- Human Rescources Manager
- Project Manager
- Supply Chain Manager
- Account Manager.

# PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

## AFTËSITË E ZHVILLIMIT PERSONAL DHE NDËRPERSONAL

1. Aftësi në analizën e të dhënave dhe marrjen e vendimeve strategjike.
2. Kapacitete për interpretimin e informacionit ekonomik dhe financiar.
3. Përvetësimi i kompetencave në fushën e financave ndërkombëtare, marketingut digjital, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe udhëheqje dhe lidership organizativ.
4. Zbatimi i projekteve reale të biznesit.
5. Kombinim i teorisë me praktikën. Zhvillimeve të ekonomisë globale; sfidave me të cilat përballet biznesi modern; ndikimit të teknologjisë, globalizimit dhe inovacionit në organizata
6. Aftësi analitike dhe vendimmarrje strategjike.

# METODA E MËSIMDHËNIES

Metoda e mësimdhënies në Bachelor në Administrim Biznesi përfshin një kombinim të teknikave dhe qasjeve që ndihmojnë në zhvillimin e njohurive dhe aftësive të studentëve. Disa nga metodat kryesore përfshijnë:

1. ORËT E LEKSIONEVE
2. STUDIMI I RASTEVE
3. GRUPET E DISKUTIMIT
4. SIMULIMET
5. PROJEKTET & PUNËT E GRUPEVE
6. PUNË PRAKTIKE & PRAKTIKË PROFESIONALE
7. SEMINARET
8. E-LEARNING & PLATFORMA ONLINE
9. REFLEKTIMI & FEEDBACK
10. HULUMTIMI

# INFORMACION PRAKTIK

PROGRAMI LËNDOR **BACHELOR NË ADMINISTRIM BIZNESI**
Programi i Bachelorit 3-vjeçar në Administrim Biznesi përfshin njohuri themelore, të avancuara dhe praktike:

Programi Bachelor ofron një kurrikulë të gjerë prej **180 kreditesh ECTS** që mbulon disa fusha kyçe për funksionimin dhe menaxhimin efikas të bizneseve.

## TË DHËNAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

**BACHELOR NË ADMINISTRIM BIZNESI 180 ECTS**

## PROGRAMI 2025-2026

BACHELOR "ADMINISTRIM BIZNESI" - Profili KONTABILITE-FINANCE - 180 ECTS

**A - LËNDË BAZË/ 15-20%/27-36 ECTS**

| Nr. | Viti | Sem | Emri i lëndës | ECTS |
|---|---|---|---|---|
| 1 | I | | Historia e Mendimit Ekonomik dhe Ndikimi i tij ne Biznes | 6 |
| 2 | I | | E drejte Biznesi dhe Perputhshmeria | 5 |
| 3 | II | | Statistike e Aplikuar dhe Analize te Dhenash | 6 |
| 4 | I | | Matematike Biznesi dhe Modelim Financiar | 6 |
| 5 | I | | Komunikim Biznesi, Aftësi të Buta dhe Inteligjenca Emocionale | 5 |
| 6 | I | | Metoda Kërkimi & Shkrim Akademik | 5 |
| | | | | 33 |

**B - LËNDË KARAKTERIZUESE TE PROGRAMIT 50-55%/96 ECTS**

| Nr. | Viti | Sem | Emri i lëndës | ECTS |
|---|---|---|---|---|
| 1 | II | | Principet e MikroEkonomise dhe Sjellja e Tregut | 5 |
| 2 | II | | Bazat e Makroekonomisë dhe Ndikimi i Politikave Ekonomike | 5 |
| 3 | II | | Anglishtja e Biznesit | 5 |
| 4 | I | | Hyrje ne Adminstrim Biznes dhe Transformim Digjital | 5 |
| 5 | II | | Parimet e Kontabilitetit | 6 |
| 6 | II | | Hyrje ne Finance dhe Buxhetim | 5 |
| 7 | II | | Principet e Marketingut | 5 |
| 8 | II | | Sjellje Organizative dhe Manaxhim Ekipi | 5 |
| 9 | II | | Kapital Njerezor dhe Manaxhim i Talenteve | 5 |
| 10 | II | | Biznesi Digjjital dhe Inovacioni | 6 |
| 11 | II | | Financa Korporative | 5 |
| 12 | II | | Manaxhimi i Sistemeve te Informacionit dhe AI | 6 |
| 13 | III | | Lidershipi dhe Vendimarrja | 5 |
| 14 | III | | Sipërmarja dhe Inovacion | 6 |
| 15 | III | | Manaxhimi I Operacioneve dhe Optimizim Procesesh | 6 |
| 16 | III | | Etika e Biznesit dhe Pergjegjesi Sociale | 5 |
| 17 | III | | Manaxhim Marketingu | 5 |
| 18 | I | | Bazat e Menaxhimit | 6 |
| | | | | 96 |

### C - LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE /12-15%/21.6-27 ECTS

| Nr. | Viti | Sem | Emri i lëndës | ECTS |
|---|---|---|---|---|
| 1 | III | | Teknika Bankare dhe Financa DIGJITALE | 5 |
| 2 | I | | Kontabilitet Financiar | 6 |
| 3 | III | | Tregje dhe Institucione Financiare | 6 |
| 4 | III | | Hyrje ne Audit | 5 |
| 5 | I+II+III | | Honor's Course | 6 |
| | | | | 22 |

### D - LËNDË PLOTËSUESE 10-15%/18-27 ECTS

| Nr. | Viti | Sem | Emri i lëndës | ECTS |
|---|---|---|---|---|
| 1 | I | | Anglishtja e Përgjithshme | 4 |
| 2 | I | | Bazat e Informatikes dhe Programimit | 4 |
| 3 | I+II+III | | Praktika Profesionale/Seminar Special | 15 |
| | | | | 23 |

### E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/3-5% /5.4-9 ECTS

| Nr. | Viti | Sem | Emri i lëndës | ECTS |
|---|---|---|---|---|
| 1 | III | 2 | Temë Diplome/Provim i Përgjithshëm Përfundimtar | 6 |
| | | | TOTAL | 180 |

BACHELOR NË ADMINISTRIM BIZNESI 180 ECTS

# PROGRAMI 2025-2026

BACHELOR "ADMINISTRIM BIZNESI" - Profili MARKETING - 180 ECTS

**A - LËNDË BAZË/ 15-20%/27-36 ECTS**

| SEMESTRI | Nr. | LËNDËT VITI I PARË | ECTS |
|---|---|---|---|
| SEMESTRI I | 1 | Matematikë Biznesi | 6 |
| | 2 | Statistike e Aplikuar | 6 |
| | 3 | Hyrje në Teknologji Informacioni | 4 |
| | 4 | Komunikim Biznesi dhe Aftesi te Buta | 5 |
| | 5 | Anglishtja e Pergjithshme | 4 |
| | 6 | Hyrje në Administrim-Biznesi & Transformim Digjital | 5 |
| **Total semestri I** | | | **30** |
| SEMESTRI II | 7 | Metoda Kërkimi & Shkrim Akademik | 5 |
| | 8 | Mendimi Ekonomik dhe Biznesi | 5 |
| | 9 | E Drejtë Biznesi & Përputhshmëri Ligjore | 6 |
| | 10 | Etika e Biznesit & Përgjegjësia Sociale | 5 |
| | 11 | Parimet e kontabilitetit | 6 |
| | 12 | Praktika Profesionale* | 3 |
| **Total Semestri II** | | | **30** |
| **Total Viti I** | | | **60** |

| SEMESTRI | Nr. | LËNDËT VITI I DYTË | ECTS |
|---|---|---|---|
| SEMESTRI III | 1 | Menaxhimi i Burimeve Njerëzore & i Talenteve | 5 |
| | 2 | Kontabilitet Drejtim Kosto | 5 |
| | 3 | Hyrje ne Finance | 5 |
| | 4 | Bazat e Marketingut | 5 |
| | 5 | Sjellja Organizative | 5 |
| | 6 | Mikroekonomi | 5 |
| **Total semestri III** | | | **30** |
| SEMESTRI IV | 7 | Anglishtja e Biznesit | 6 |
| | 8 | Financa e Korportatave | 5 |
| | 9 | Bazat e Menaxhimit | 6 |
| | 10 | Menaxhim Marketingu | 5 |
| | 11 | Makroekonomi | 5 |
| | 12 | Praktika Profesionale* | 3 |
| **Total semestri IV** | | | **30** |
| **Total Viti II** | | | **60** |

| SEMESTRI | Nr. | LËNDËT VITI I TRETË PROFILI MARKETING | ECTS |
|---|---|---|---|
| SEMESTRI V | 1 | Menaxhimi I Operacioneve | 6 |
| | 2 | Sipërmarja dhe Inovacioni | 6 |
| | 3 | Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit & Inteligjecë Artificiale | 6 |
| | **Lende me Zgjedhje** | | |
| | 4 | Marketing Digjital (LZ) | 6 |
| | 5 | Komunikim Marketing i Integruar (LZ) | 6 |
| **Total semestri V** | | | **30** |
| SEMESTRI VI | 6 | Lidershipi & Vendimmarrja | 5 |
| | **Lende me Zgjedhje** | | |
| | 7 | Sjellje Konsumatore (LZ) | 5 |
| | 8 | Menaxhimi i Shitjeve (LZ) | 5 |
| | 9 | Praktika Profesionale* | 9 |
| | 10 | Diploma/Provimi I formimit | 6 |
| **Total semestri VI** | | | **30** |
| **Total Viti III** | | | **60** |
| **TOTAL Programi Bachelor AB Menaxhim** | | | **180** |

# PROGRAMI 2025-2026

BACHELOR "ADMINISTRIM BIZNESI" - Profili Manaxhim - 180 ECTS

**A - LËNDË BAZË/ 15-20%/27-36 ECTS**

| Nr. | Viti | Sem | Emri i lëndës | ECTS |
|---|---|---|---|---|
| 1 | I | | Historia e Mendimit Ekonomik dhe Ndikimi i tij ne Biznes | 6 |
| 2 | I | | E drejte Biznesi dhe Perputhshmeria | 5 |
| 3 | II | | Statistike e Aplikuar dhe Analize te Dhenash | 6 |
| 4 | I | | Matematike Biznesi dhe Modelim Financiar | 6 |
| 5 | I | | Komunikim Biznesi, Aftësi të Buta dhe Inteligjenca Emocionale | 5 |
| 6 | I | | Metoda Kërkimi & Shkrim Akademik | 5 |
| | | | | 33 |

**B - LËNDË KARAKTERIZUESE TE PROGRAMIT 50-55%/96 ECTS**

| Nr. | Viti | Sem | Emri i lëndës | ECTS |
|---|---|---|---|---|
| 1 | II | | Principet e MikroEkonomise dhe Sjellja e Tregut | 5 |
| 2 | II | | Bazat e Makroekonomisë dhe Ndikimi i Politikave Ekonomike | 5 |
| 3 | II | | Anglishtja e Biznesit | 5 |
| 4 | I | | Hyrje ne Adminstrim Biznes dhe Transformim Digjital | 5 |
| 5 | II | | Parimet e Kontabilitetit | 6 |
| 6 | II | | Hyrje ne Finance dhe Buxhetim | 5 |
| 7 | II | | Principet e Marketingut | 5 |
| 8 | II | | Sjellje Organizative dhe Manaxhim Ekipi | 5 |
| 9 | II | | Kapital Njerezor dhe Manaxhim i Talenteve | 5 |
| 10 | II | | Biznesi Digjjital dhe Inovacioni | 6 |
| 11 | II | | Financa Korporative | 5 |
| 12 | II | | Manaxhimi i Sistemeve te Informacionit dhe AI | 6 |
| 13 | III | | Lidershipi dhe Vendimarrja | 5 |
| 14 | III | | Sipërmarja dhe Inovacion | 6 |
| 15 | III | | Manaxhimi I Operacioneve dhe Optimizim Procesesh | 6 |
| 16 | III | | Etika e Biznesit dhe Pergjegjesi Sociale | 5 |
| 17 | III | | Manaxhim Marketingu | 5 |
| 18 | I | | Bazat e Menaxhimit | 6 |
| | | | | 96 |

## C - LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE /12-15%/21.6-27 ECTS

| Nr. | Viti | Sem | Emri i lëndës | ECTS |
|---|---|---|---|---|
| 1 | III | | Manaxhimi I Shitjes | 5 |
| 2 | I | | Kerkim Tregu | 6 |
| 3 | III | | Strategji Biznesi | 6 |
| 4 | III | | Administrim Fiskal | 5 |
| 5 | I+II+III | | Honor's Course | 6 |
| | | | | 22 |

## D - LËNDË PLOTËSUESE 10-15%/18-27 ECTS

| Nr. | Viti | Sem | Emri i lëndës | ECTS |
|---|---|---|---|---|
| 1 | I | | Anglishtja e Përgjithshme | 4 |
| 2 | I | | Bazat e Informatikes dhe Programimit | 4 |
| 3 | I+II+III | | Praktika Profesionale/Seminar Special | 15 |
| | | | | 23 |

## E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/3-5% /5.4-9 ECTS

| Nr. | Viti | Sem | Emri i lëndës | ECTS |
|---|---|---|---|---|
| 1 | III | 2 | Temë Diplome/Provim i Përgjithshëm Përfundimtar | 6 |
| | | | TOTAL | 180 |

# BACHELOR NE ADMINISTRIM BIZNESI

Kohëzgjatja:
**3 vite akademike (6 semestra)**
Forma e studimit:
**Me kohë të plotë**
Gjuha:
**Shqip**

## NA KONTAKTONI:

+355 69 70 66 966
info@tbu.edu.al
www.tbu.edu.al
Rruga Rezervat e Shtetit,
Lundër, Tiranë, Shqipëri

DIPLOMA BACHELOR NË
**ADMINISTRIM BIZNESI**
**(120 ECTS)**

## KRITERET E PRANIMIT:

- Diplomë e nivelit Bachelor;
- CV;
- Letër Motivimi;
- Dokument Identifikimi.

Për më shumë informacion
dhe për të aplikuar, vizitoni
faqen tonë të internetit:
www.tbu.edu.al

KONTAKT:

**DR. GERTI DAJÇI**
Drejtor Akademik

gerti.dajci@tbu.edu.al
+355 69 935 4070